



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

PREZANTIMI I RAPORTIT VJETOR 2023

27 qershor 2024

Kryetari i ERE-s, z. Petrit Ahmeti, prezantoi sot në Kuvendin e Shqipërisë, Raportin Vjetor të ecurisë së sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror dhe të veprimtarisë së ERE për vitin 2023, i cili paraqet një përshkrim të detajuar si dhe të dhëna specifike mbi ecurinë e sektorëve, duke pasqyruar në mënyrë krahasimore treguesit e këtij viti me vitet parardhës.

Z. Ahmeti renditi për Anëtarët e Kuvendit objektivat kryesore të Entit Rregullator të Energjisë, punën e bërë gjatë vitit që lamë pas në kuadër të ushtrimit të detyrave në lidhje me licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në sektor, monitorimin e tregut të energjisë, hartimit të kuadrit rregullator, si dhe shqyrtimit dhe përcaktimit të tarifave dhe çmimeve në përputhje me metodologjitë respektive.

Kryetari i ERE-s referoi gjithashtu mbi të dhënat e prodhimit të energjisë elektrike, ku kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri më 31 Dhjetor 2023 është rreth 2,675 MW, me një nivel rritje nga viti 2022 prej rreth 26 MW; si dhe foli për centralët e prodhimit të energjisë elektrike të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike (2,288 MW) ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes (382 MW).

Kuvendit u informua dhe mbi gjetjet që rezultojnë nga krahasimi i të dhënave historike nga të cilat vërehet se:

- prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2023, në sasinë prej 8,796 GWh rezulton mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009-2023, çka bën që viti 2023, të konsiderohet një vit i mirë hidrik nga pikëpamja e prodhimit të energjisë elektrike, me një rritje prej 2,026 GWh mbi prodhimin mesatar të energjisë elektrike në periudhën 2009-2023.
- nivelit të arkëtimeve dhe humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit, dhe në sistemin e shpërndarjes; të cilat gjithashtu kanë shënuar përmirësim dhe janë në përputhje me targetin e miratuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave. Humbjet e përgjithshme të raportuara nga shoqëria për vitin 2023 arrijnë në 18.93%, duke shënuar kështu ulje të nivelit të humbjeve krahasuar edhe me vitin 2022. Niveli total i arkëtimeve i raportuar është 99.4 % kundrejt energjisë elektrike të faturuar. Ky nivel arkëtimesh për vitin 2023 rezulton me rritje, krahasuar me nivelin e arkëtimeve të realizuara për vitin 2022.
- konsumi total i energjisë elektrike të realizuar për vitin 2023 prej 7,875,861 MWh, i cili është më i ulët se ai i vitit 2021, që është konsumi maksimal i arritur.



Për sa i përket sektorit të Gazit Natyror, në Raport është pasqyruar ecuria e furnizimit me gaz në botë dhe pozicioni strategjik i vendit tonë, konsumi i gazit dhe trendi i përdorimit të tij në vendet e BE ku vihet re një rënie e konsumit të gazit.

Pas prezantimit të Raportit Vjetor, në Kuvend pati argumente pozitive, por dhe kritika dhe replikë, ndër të cilat Z. Pëllumbi dhe disa prej anëtarëve të tjerë të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, përgëzuan punën e bërë nga ERE për gjetjen e ekuilibrit mes shtetit, biznesit dhe konsumatorit, për funksionimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), e cila filloi operimin në orën 00:00 të datës 12.04.2023, për transparencën, diversifikimin e burimeve të energjisë, rritjen e volumeve të energjisë të tregtuar në Bursën Shqiptare të Energjisë, trendin e uljes së humbjeve të energjisë në sistemin e shpërndarjes, për memorandumet e nënshkuara për bashkimin e tregut të një dite në avancë brenda vitit 2026 etj.

Sa pasqyruar në Raport, u vlerësua si një kapërcim i madh i pasojave negative të lëna pas nga vitet e tranzicionit për sektorin energjitik, ku inkurajues është prodhimi i energjisë nga prodhues të vegjël.

Komisioni gjithashtu paraqiti Rezolutën për vitin e ardhshëm për Entin Rregulator të Energjisë, me 12 rekomandime, mbi të cilat ERE do të mbështesë objektivat e saj në vazhdim.

Kopje e këtij raporti gjendet e publikuar në faqen e internetit të ERE në linkun e mëposhtëm:
<https://www.ere.gov.al/sq/publikime/raporte-vjetore> .